



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 221, datë 23.10.2024

PËR
“TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Znj. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Znj. Ledina RIZA	Anëtar
3. Znj. Arta MANDRO	Anëtar
4. Z. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Z. Sokol STOJANI	Anëtar
6. Z. Moisi DUDA	Anëtar
7. Z. Vatë STAKA	Anëtar
8. Z. Olger EMINAJ	Anëtar
9. Z. Erind GERMENJI	Anëtar
10. Z. Erind MERKURI	Anëtar
11. Z. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 23/10/2024, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 18 dhe vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Mbi transferimin me pëlqim të një prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”

BAZA LIGJORE:

- i. Neni 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa "a" të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;
- ii. Nenet 164, pika 8, 166, pikat 2 dhe 6, 189, pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 115/2016, "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", i ndryshuar.
- iii. Nenin 46 pika 1, të Ligjit Nr.96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar.
- iv. Rregullorja "*Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit*".

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues Nr. 2429, datë 22.10.2024, i Komisionit i Zhvillimit të Karrierës;
- ii. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

Nisur nga gjendja në të cilën ndodhet dhe kërkesa e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Këshilli i Lartë i Prokurorisë mori në shqyrtim situatën në këtë zyrë prokurorie.

Me urdhrin nr. 19, datë 30.01.2024, "*Për strukturën organike të prokurorive të shkallës së parë dhe prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm*" të ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm ka përcaktuar numrin prej 20 prokurorësh në zyrën e prokurorisë Elbasan.

Aktualisht, në këtë zyrë ka gjithsej 13 vakanca, 10 prej tyre të përkohshme (me vendim pezullimi nga KPK-ja: Binas Nina, Etleva Mura, Hektor Mushi, Mustafa Turku, Petref Asllani, Pranvera Selita, Rajmonda Berisha, Neritan Hoxha; për shkak të komandimit në KLP: Gentjan Habazaj; për shkak të caktimit të përkohshëm në zyrën e prokurorisë Tiranë: Platin Aliçka) dhe 3 vakanca të përhershme pra, organika e kësaj zyre prokurorie është e plotësuar në masën 35%.

Drejtuesi i zyrës së prokurorisë Elbasan, është drejtuar në mënyrë të vazhdueshme Këshillit (e fundit me shkresën nr. 6898 prot., datë 03.07.2024), ku ka parashtruar vazhdimisht situatën e vështirë dhe kërkesën për plotësim të organikës, ku përveç ngarkesës së punës shfaqen vështirësi edhe sa i takon funksionalitetit të kësaj zyre sidomos në lidhje me krijimin e seksioneve përkatëse të parashikuara nga ligji.

Në këto kushte, Këshilli me Vendimet nr. 150, 151 dhe 152 datë 24.07.2024, caktoi përkohësisht pranë kësaj zyre prokurorin Gëzim Spahiu, deri në datë 28.10.2024.



Duke qenë se në përfundim të këtij afati, këto pozicione bëhen sërish vakante, lind nevoja e plotësimit të tyre.

Vakancat e përkohshme të krijuara në zyrën e prokurorisë Elbasan janë krijuar kryesisht për shkak të procesit *vetting* dhe Komandimeve në Këshill. Asnjëra prej këtyre vakancave nuk pritet apo nuk parashikohet të bëhet e lirë në një periudhë më pak se 3 muaj.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht Ligji për Statusin, për plotësimin e përkohshëm të vakancave ekzistuese në organikat e prokurorive, parashikon përveç mjetit ligjor të “Lëvizje paralele” dhe tre procedura të tjera, ku përfshihen “Caktim i përkohshëm”, “Transferim me pëlqim” dhe “Transferim pa pëlqim”.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin Nr.13 datë 16.02.2024, ka shpallur ndër të tjera edhe fillimin e procedurave për plotësimin e 2 vakancave në prokurorinë e Elbasanit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Këto procedura aktualisht janë në vijim, për shkak të kërkesave nga kandidatët për kryerjen e vlerësimeve etike dhe profesionale të përsheptuara, vlerësime të cilat janë në proces duke u kryer nga Këshilli. Këto procedura nuk pritet të përfundojë brenda një afati të shkurtër, por në çdo rast plotësimi i 2 vakancave të përhershme në këtë zyrë prokurorie, nuk do të ishte i mjaftueshëm për të adresuar në mënyrë sa më të shpejtë vakancat e shumta të krijuara në këtë Prokurori.

Këshilli, duke mbajtur në konsideratë edhe diskutimet e mëparshme të zhvilluara në seancë plenare, vlerësoi se mekanizmi ligjor që duhet të aplikohet në këtë rast duhet të jetë “transferim i përkohshëm me pëlqim” sipas parashikimit të nenit 46 “Transferimi i Përkohshëm” të Ligjit për Statusin, i cili sanksionon kriteret dhe rregullat procedurale lidhur me këtë mekanizëm të plotësimit të vakancave.

Konkretisht pika 1 e këtij neni sanksionon:

[...] 1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm, Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët, i cili përmbush kriteret për t'u transferuar ose për t'u ngritur në detyrë në pozicionin përkatës, të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. Në këtë rast, Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin magjistrati. [...]

Duke qenë se prokurori Gëzim Spahiu ushtron detyrën prej tre muajsh në prokurorinë Elbasan, për të garantuar vijimësinë në trajtimin e dosjeve që ky prokuror ka në ngarkim, nga ana e relatorit u kërkua dhënia e pëlqimit të prokurorit dhe mendimi i drejtuesit të Prokurorisë Shkodër për transferimin e zotit Spahiu për një periudhë deri në një vit.

Në e-mailin zyrtar të Relatorit më datë 14 tetor është administruar përgjigja e prokurorit Gëzim Spahiu, i cili konfirmon dhënien e pëlqimit për transferimin e tij në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për një periudhë 1 vjeçare.



Ndërsa me e-mailin e datës 15.10.2024, drejtuesi i kësaj prokurorie ka kundërshtuar komandimin e prokurorëve nga zyra të cilën ai drejton, duke e argumentuar me gjendjen e kësaj prokurori sa i takon organikës së saj, si dhe ngarkesës së shtuar të procedimeve të cilat kjo zyrë ka në proces.

Në vlerësim të përgjigjes së administruar nga drejtuesi i kësaj prokurorie, bazuar në nenin 9 të rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, analizohet si vijon:

Neni 9 pika e rregullores që lidhet me shqyrtimin e dhënies së pëlqimit për transferim të përkohshëm përcakton se, “Në vlerësimin e rasteve për transferim të përkohshëm, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës krahas verifikimit të plotësimit të kriterëve të transferimit nga ana e prokurorit që ka dhënë pëlqimin, vlerëson informacionet më të fundit të përgatitura nga Prokurori i Përgjithshëm lidhur me statistikën e ngarkesës së punës së prokurorive si dhe mendimin e Drejtuesit të prokurorisë ku ushtron funksionet prokurori në fjalë, lidhur me ngarkesën në punë të prokurorit si dhe me cënimin e funksionalitetit të prokurorisë”.

Në interpretim të kësaj dispozite, mendimi i drejtuesit të prokurorisë ku ushtron funksionin prokurori në fjalë, lidhet në radhë të parë me ngarkesën e punës së prokurorit që kërkohet të transferohet. Ky prokuror ka rreth 3 muaj që është caktuar përkohësisht në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe për rrjedhojë nuk ka dosje apo ngarkesë në prokurorinë e rrethit Shkodër.

Sa i takon cënimin të funksionalitetit të prokurorisë Shkodër, vihet re se duke ju referuar organikës aktuale të kësaj prokurorie pasi janë hequr edhe 2 prokurorët e caktuar përkohësisht në prokurorinë e Elbasanit, është e plotësuar në masën 60% (12 prokurorë në detyrë nga 20 që është organika). Sa i takon ngarkesës së kësaj zyre, referuar informacionit të administruar nga Prokuroria e Përgjithshme, ngarkesa e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm është në përgjithësi e lartë, kjo për shkak të vakancave të krijuara në sistem dhe prokuroria e rrethit Shkodër nuk është ajo me ngarkesën më të lartë, në raport me organikën faktike të kësaj zyre siç u referua më sipër.

Për këtë shkak duke u bazuar edhe në parashikimin e fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 9 të rregullores i cili parashikon se: “..... Mendimi i Drejtuesit të Prokurorisë nuk është përcaktues”, vlerësohet të vijohet me procedurat e transferimit të tij me pëlqim në prokurorinë e rrethit Elbasan.

Nisur nga analiza e kryer sa më sipër, Këshilli mori në shqyrtim si kandidaturë të përshtatshme prokurorin Gëzim Spahiu.

Zoti Gëzim Spahiu është emëruar prokuror dhe është caktuar në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër me vendimin e KLP-së nr.39, datë 11.02.2020;

- Me vendimin e KLP-së nr. 64, datë 13.04.2022, është caktuar përkohësisht si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë nga data 14.04.2022 – 18.04.2022;



- Me vendimin e KLP-së nr. 32, datë 07.02.2023, është *caktuar përkohësisht* si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë nga data 08.02.2023 – 12.02.2023;
- Me vendimin e KLP-së nr. 150, datë 24.07.2024 është *caktuar përkohësisht* si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nga data 29.07.2024 – 28.10.2024.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara rezulton se, prokurori Spahiu plotëson kriteret e vendit të punës ku do të transferohet, si dhe rezulton se nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga ana tjetër nuk janë evidentuar problematika të njohura për këtë prokuror në lidhje me përballimin e ngarkesës në punë.

Këshilli vlerëson që për kandidatin e sipërcituar të aplikohet transferimi i përkohshëm me pëlqim në bazë të nenit 46 pika 1 të Ligjit për Statusin, dhe nenit 10 të rregullores “*Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit*” për një afat një vjeçar.

Në lidhje me masën e kompensimit mujor për magjistratin që transferohet përkohësisht, neni 15 pika 2 e ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar, përcakton se:

[...] *Magjistrati në skemën e delegimit, **magjistrati i transferuar përkohësisht** ose magjistrati i caktuar përkohësisht, kur delegohet, transferohet përkohësisht ose caktohet përkohësisht për një periudhë kohore më të gjatë se periudha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përfiton një kompensim mujor në masën e jo më shumë se 80 për qind të pagës referuese bazë. Ky kompensim mbulon çdo shpenzim për qëndrimin dhe transportin e magjistratit në gjykatën ose prokurorinë ku magjistrati është deleguar, transferuar përkohësisht ose caktuar përkohësisht. [...]*

Duke qenë se aktualisht Këshilli me vendimin nr.386, datë 30.11.2023, ka miratuar Rregulloren për “*Caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë*”, pagesa e prokurorëve që propozohen për t’u transferuar, do të bëhet sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se:

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, zoti Gëzim Spahiu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër duhet të transferohet përkohësisht me pëlqimin e tij për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nga data 29.10.2024 deri 28.10.2025.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149 pika 1, 149/a pika 1 germa a), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 46 pika 1, të ligjit Nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar, në nenet 9 dhe 10 të Rregullores *“Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”*, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

V E N D O S I:

1. Zoti Gëzim Spahiu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, transferohet përkohësisht me pëlqimin e tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Zoti Gëzim Spahiu do të ushtrojë detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, duke filluar nga data 29.10.2024 deri 28.10.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim z. Gëzim Spahiu, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
4. Gjatë periudhës së transferimit zoti Gëzim Spahiu do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, sipas përcaktimeve të vendimit Nr.386, datë 30.11.2023, për miratimin e Rregullores për *“Caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”*.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.10.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR

Artë Mandro

ANËTAR

Vatë Staka

ANËTAR

Erion Fejzulla

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Olger Eminaj

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR

Erind Germenji

ANËTAR

Erind Merkuri